



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°6/2022

Hagë, 17/02/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Thaçi dhe të tjerë*, ditën e djeshme Gjykatësi i Procedurës Paraprake planifikoi një seancë për në datën 22 shkurt 2022. Gjatë seancës palëve do t'u jepet mundësia të trajtojnë disa aspekte të ngritura prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake në vijim të propozimit të ZPS-së për administrimin e informacionit konfidencial dhe të kontaktit me dëshmitarët.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Paneli i Gjykatës së Apelit i rrëzoi të gjitha pikat e parashtruara në apelin e z. Shala kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në të cilin urdhërohej vazhdimi i paraburgimit, me përjashtim të njëjës. Paneli i Apelit urdhëroi Gjykatësin e Procedurës Paraprake të kërkonte më shumë informacion nga Administratorja lidhur me sistemin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës si dhe të ftonte Mbrojtjen të mblidhte informacion në lidhje me gatishmërinë dhe mundësinë e Belgjikës për zbatimin e kushteve të lirit.

Në zbatim të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 14 shkurt urdhëroi Administratoren që brenda datës 22 shkurt të paraqesë informacion të mëtejshëm lidhur me sistemin e paraburgimit si dhe Mbrojtjen, që të dorëzojë parashtrimin e vet për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, përfshirë edhe rezultatin nga komunikimet me Belgjikën, brenda datës 2 mars.

Po ashtu, në çështjen *Shala*, më 11 shkurt, Paneli i Apelit rrëzoi "Apelin kundër Vendimit mbi Mocionin që ngre Kundërshtime Lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara", të z. Shala.





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°6/2022

Hagë, 17/02/2022

Dy vendimet e Panelit të Gjykatës së Apelit si dhe vendimin e urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mund t'i gjeni në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

**Pyetje nga gazetarët**  
Nuk pati pyetje

